



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. 2768/Prot.
1

Tiranë, më 07/10/2025

Drejtuar: **Z. Niko PELESHI**

Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

OBJEKTI: Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm të Kuvendit të Shqipërisë për Reformën Zgjedhore

BAZA LIGJORE: Neni 77, pika 1, i Kushtetutës, neni 24 i Rregullores së Kuvendit

I nderuar zoti Kryetar,

Në bazë të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës dhe neneve 24 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, ne deputetët propozues kërkojmë ngritjen e një Komisioni të Posaçëm të Kuvendit të Shqipërisë për Realizimin e Reformës Zgjedhore.

Ngritja e këtij Komisioni të Posaçëm për Reformën Zgjedhore është një nevojë për t'u dhënë zgjidhje ligjore të gjitha problematikave të evidentuara gjatë proceseve zgjedhore, si dhe në raportet dhe rekomandimet e OSBE/ODIHR duke përfshirë edhe rekomandimet e pritshme të raporti të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara më 11 maj 2025.

Kjo kërkesë përkon edhe me një prioritet të mazhorancës parlamentare që është realizimi i reformës zgjedhore.

Kuvendi me miratimin e ligjit nr. 81/2024 ka pasur si synim në radhë të parë reflektimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, veçanërisht për zbatimin e vendimit nr. 38/2022 të Gjykatës Kushtetuese.

Në formulimin e neneve që lidhen me votimin nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Kuvendi synon të garantojë çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në datën e zgjedhjeve të marrë pjesë në votim duke shprehur lirisht vullnetin e tij për deputetët e ardhshëm në Kuvendin e Shqipërisë.

Edhe ndryshimet e tjera që ka miratuar Kuvendi për të përmirësuar kuadrin ligjor zgjedhor nuk kanë bërë të mundur realizimin e reformës e zgjedhore. Kjo evidentohet edhe në progres raportet e Komisionit European për Shqipërinë.

Në Progres Raportin për Shqipërinë më 30.10.2025 në analizën e ecursisë së përmirësimit të kuadrit ligjor zgjedhor theksojes se “ *Parlamenti miratoi ndryshimet në Kodin Zgjedhor, pjesërisht në përgjigje të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, duke mundësuar votimin jashtë vendit nga diaspora shqiptare, duke futur lista pjesërisht të hapura të kandidatëve (lista të përziera të kandidatëve) dhe ndryshimet në koeficientin e partisë. Megjithatë, rekomandimet e tjera të pazgjidhura të OSBE/ODIHR si dhe të Komisionit të Venecias mbeten për t'u adresuar* ”-

Komisioni i Posaçëm nëpërmjet një qasje gjithëpërfshirëse dhe transparente do të drejtojë dhe koordinojë një proces reformimi me synimin:

- a) hartimin e ndryshimeve legislative për reformën zgjedhore, në veçanti trajtimin e rekomandimeve të raporteve të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet vendore të 14 majit 2023, zgjedhjet e mëparshme të patrajuara dhe të raportit të pritshëm për zgjedhjet e 11 majit 2025;
- b) trajtimin e rekomandimeve të institucioneve përgjegjëse për zgjedhjet, të partive politike parlamentare dhe organizatave jofitimprurëse;
- c) si dhe hartimin e ligjit për financimin e partive politike si kërkesë edhe e Komisionit European.

Komisioni European në Progres Raportin (2025) ka theksuar se : *Janë ndërmarrë disa hapa drejt një reforme të legjislacionit për konfliktin e interesit dhe sinjalizuesit, megjithëse legjislacioni për parandalimin e korrupsionit mbetet kompleks dhe i paplotë. **Rregullimi i konfliktit të interesit, lobimit dhe financimit të partive politike, mbetet i paplotë.** Ndërsa u ndërmorën disa hapa paraprakë drejt forcimit të efikasitetit të rrjetit të parandalimit të korrupsionit, duke çuar përpara punën për përafrimin e ligjit për konfliktin e interesit me standardet evropiane, nevojitet ende punë e mëtejshme për të përafruar plotësisht ligjet për mbrojtjen e sinjalizuesve, lobimin, donacionet dhe financimin e partive politike me standardet evropiane..*

Regullimi i Kuadrit Ligjor për financimin e Partive Politike është përmëndur dhe në qëndrimin e përbashkët të Bashkimit European më 11. Tetor 2024 ku është theksuar se: “ *Është e domosdoshme të sigurohet transparencë më e madhe në financimin e partive politike, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Me zhvendosjen e fushatave elektorale gjithnjë e më shumë në mjedisin online, kërkohet vëmendje e veçantë ndaj fushatave që zhvillohen në internet dhe nga palët e treta. Zbatimi i kuadrit ligjor për donacionet dhe sponsorizimet duhet të shqyrtohet plotësisht në dritën e standardeve evropiane*

Për këtë arsye, hartimin e një ligji për financimin e partive politike në kërkesën për ngritjen e Komisionit të posaçëm për Realizimin e Reformës Zgjedhore është përfshirë në objektin e saj


Komisioni propozohet të drejtohet nga dy bashkëkryetarë, një nga Partia Socialiste dhe një nga Partia Demokratike dhe do të ketë një përbërje me përfaqësues nga gjitha grupet parlamentare.

Komisioni në veprimtarinë e tij do të mbështetet nga ekspertiza e ekspertëve të OSBE/ODIHR-it, Këshillit të Europës, si edhe të ekspertëve të caktuar nga vetë Komisioni.

Në lidhje me afatin e veprimtarisë së këtij Komisioni të Posaçëm, propozojmë që ky afat të jetë 9 muaj duke filluar nga data e miratimit për ngritjen e tij.

Bashkëlidhur kërkesës edhe projektvendimi "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore".

DEPUTETËT

1.  Fatos Nano
2. DAMIAN GJAVRI
3. ERION MALAJ
4. ERMAZ ELI
5. Ulsi  Maja
6. Klementin  Lela
7. Anila Denol
8.  Zylyftar
-  Anila